

**FJALA HYRËSE E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z.SHKELQIM CANI NË  
KONFERENCËN PËR SHTYP--23 JANAR 2003**

Të nderuar përfaqësues të medias,

Duke ju falenderuar për praninë tuaj, kam kënaqësinë të deklaroj se takimi i sotëm me delegacionin e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës të kryesuar nga z.Ajri Begu, ishte në vazhden e takimeve dhe të komunikimit të vazhdueshëm mes Bankës së Shqipërisë Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, i cili luan rolin e Bankës Qëndrore të Kosovës.

Ky takim, është në funksion të rritjes së bashkëpunimit jo vetëm në sferën e bankingut qendror dhe të bashkëpunimit mes bankave në të dy vendeve, por edhe në aspektet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe të Kosovës në përgjithësi.

Mes Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, ekzistojnë marrëdhënie shumë të mira në të gjitha fushat, dhe ajo çka është më e rëndësishme, tashmë kemi vendosur edhe bashkëpunimin konkret në drejtim asistencës teknike, të shkëmbimit të informacionit dhe të sistemit të pagesave.

Marrëdhëniet tona, veçse miqësore dhe vëllazërore, janë të institucionalizuara dhe po ecin në kanalet zyrtare në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme të Bashkëpunimit mes dy institucioneve dhe Memorandumit të Mirëkuptimit mes Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, të nënshkruara që në muajin prill të vitit të kaluar.

Dua të theksoj se në bazë të këtyre dokumenteve, marrëdhëniet mes dy institucioneve në sferën e mbikëqyrjes bankare janë sipas standardeve ndërkombëtare të 25 parimeve bazë të Bazelit, ku parashikohet të realizohet edhe verifikimi i aksionerëve në bankat përkatëse me synim parandalimin e pastrimit të parave.

**KONFERENCA E PËRBASHKËT PËR SHTYP E GUVERNATORIT TË BANKËS  
SË SHQIPËRISË Z.SHKËLQIM CANI ME PËRFAQËSUES TË AUTORITETIT  
BANKAR DHE TË PAGESAVE TË KOSOVËS  
Tirane 23 janar 2003**

Vizita e autoriteteve të larta financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës bëhet në vijim të vizitës që unë pata verën e kaluar në Kosovë dhe natyrisht do t'i shërbejë forcimit të marrëdhënieve mes dy institucioneve tona. Objekti i takimit ishte gjuha e përbashkët për mjaft probleme, të cilat kanë të bëjnë me transmetimin e eksperiencës të dyanshme të dy institucioneve tona.

U bisedua kryesisht për shkëmbim përvoja në fushën e mbikëqyrjes, të pagesave, të politikës monetare dhe mënyrës se si është organizuar një bankë qendrore, në funksion të përmirësimit të punës së dy institucioneve tona. Natyrisht që, meqenëse integrimi ekonomik mes dy vendeve po vjen në rritje, pjesëe e diskutimeve ishte vazhdimësia e marrëdhënieve mes dy institucioneve por nderkohe edhe midis Kosoves dhe Shqiperise.

Në përfundim do doja të falenderoja të tre miqtë nga Kosova dhe shpresoj se do të vazhdojmë marrëdhëniet e mira të vendosura mes dy institucioneve duke shprehur në të njëjtën kohë edhe besimin dhe angazhimin nga ana e Bankës së Shqipërisë për thellimin e këtij bashkëpunimi të frytshëm që ne kemi realizuar deri tani.